

KONTRATE THEMELIMI

PER THEMELIMIN E SHOQERISE TURISTIKE ME PERGJEGJESI

TE KUFIZUAR "TURIST ALBANIA-DURRES" SHPK.

Sot, me 26.9.1994, me vullnet te lirs, une Entela Anastasi e bija e zisit, lindur me 1972 ne Vlorë dhe banuese ne Durrës, lagje 17 rruga "Deshmoret", pallati 998 perpijoj kete kontrate, akt themelim, për krijimin e shoqerise turistike private.-

Neni 1

Forma e organizimit te shoqerise eshte: Shoqëri turistike me pergjegjesi te kufizuar (SHPK).-

Emërtimi i shoqërise eshte "TURIST ALBANIA-DURRES" qe krijon pa ortakë ,me nje person te vetem.-

Neni 2

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

-Grupe turistike, brenda e jashte vendit.-

-Organizim udhetimi brenda e jashte vendit.-

-Hoteleri.-

-Prerje biletash per udhetim me avion e anije detare.-

-Perkthime ne disa gjuhe te huaja dhe anasjelltas.-

-Fotokopjime.-

-Këmbim valute.-

-Veprime tregtare me pakice e shumice, brenda e jashte vendit te mallrave te ndryshme, Import-Eksport.

-Çdo aktivitet tjeter tregtar, sherbimi, financiar e te tjere qe do te ndikojë ne zhvillimin e shoqerise.-

Neni 3

Selia e shoqerise do te jete ne lagjen 17, rruga "Deshmoret" Nr.998, Durrës.-

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 3000 (tremije) dollar amerikan, i cili eshte ivestuar dhe derdhur nga Entela Anastasi

Neni 5

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhë mbi 10 vjet.-

Ky afat mund te ndryshojë me vendim te themeluesit.-

FAQE 2

Neni 6

I gjithë fitimi që do të realizohet nga kjo veprimtari do të përkase vetëm themeluesit.-

Neni 7

Shpenzimet për themelimin e shoqërisë do të përballohen vetëm nga themeluesja Entela Anastasi.

Neni 8

Viti i parë financiar do të mbyllet me 31 dhjetor të çdo viti.-

Neni 9

Shoqëria do të funksionojë në përputhje me Statutin e Shoqërisë me ligjin "Për shoqëritë Tregtare" dhe me të gjithë dispozitat tjera ligjore që janë në fuqi apo që do të dalin në vone e që kanë lidhje me veprimtarinë e kësaj shoqërie turistike.- -

THEMELUESI I SHOQËRISE

(ENTELA ANASTASI)

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

DIOMA E NOTEREVE

Nr. 94 Rep., Nr. 544 Kol.

VERTETIM

Sot, me njëzet e gjashtë shtator, nëntëdhjetë e katër, ditë kanë para meje Ali Turku, noter në Durrës, u paraqit me cilesinë e themeluesit të kësaj shoqërie Entela Zisi Anastasi, e dl. 1972, banuese në Durrës, lagje 17, rruga "Dëshmoret", 998, madhore me zotësi të plote për të vepruar, person i njohur prej meje, e cila, pasi e lexoi këtë kontratë themelimi dhe e gjeti të rregullt, e nënshkroi me dëshirë e vullnet të lire në prezencën time. Ua noteri vertetoj.- -



NOTERI
(ALI TURKU)

FAQE 2

- Grupe turistike,branda e jashte vendit.-
- Organisim udhetimi brenda e jashte vendit.-
- Hoteleri.-
- Prerje biletash per udhetim me avion e anije.-
- Perkthime ne disa gjuhe te huaja dhe anasjellitas.-
- Fotokopjime.-
- Kembim valute.-

Veprime tregtare me pakice e shumice,brenda e jashte vendit te mallrave te ndryshme,Import-eksport.-

-Cdo aktivitet tjeter tregtar,sherbimi,financiar e te tjere qe do te ndikojne ne zhvillimin e shoqerise.-

Neni 6

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin,vendqenrimin si dhe objektin e veprimitarise se saj sipas vendimeve qe merr themeluesi i saj.-

Neni 7

Shoqeria do te funksionojne sipas normave qe permban ky statut dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.-

Ajo fiton personalitetin e saj juridik me rregjistrimin ne Gjykatën e Rrethit Tirane,ndersa aktiviteti i saj do te filloj mbas rregjistrimit ne Organin Tatimor Durres.-

Neni 8

Shoqeria turistike "TURIST ALBANIA-DURRES" SH.K do te funksionojne ne kushtet e konkruences se lire e te ligjeshme,e per rrjedhoje ajo lirisht do te caktojne vete omimet e sherbimit,te shitjes e blerjes e te tjere,sipas kerkeses dhe ofertes.-

Neni 9

Shoqeria garanton dhe pergjigjet per te gjithë detyrimet qe lindin nga aktiviteti i saj i ligjeshem.-

Neni 10

Shoqerija ka te drejte te punesoje punonjes te profesioneve e specilaiteteve te ndryshme sipas nevojës se punes qe do t'i paraqiten asaj.Punesimi i tyre do te behet me kontrate te vecante sipas dispozitiveve ligjore qe rregullojne maredheniet e punes midis shoqerise dhe te punesuarit.-

FAQE 3

Neni 11

Kapitali themeltar i shoqerise "TURIST ALBANIA-DURRES" eshte 3000 (tremije) dollare amerikan.

Ky kapital eshte i venstuar nga Entela Anastasi themeluese e kesaj shoqerise dhe eshte derdhur ne Banken Kombetare Tregtare Durres.

Neni 12

Themeluesi i kesaj shoqerije ka te drejte te smadhoje pjeset e ketij kapitali themeltar ne para ose me ane te kontributeve ne natyre.--

Zmadhimi i pjeseve te ketij kapitali ne para behet me nenshkrimin e themeluesit te shoqerise. Po keshtu behet edhe smadhimi i kontributit ne natyre, por pasi me pare te jete bere vleresimi nga e eksperte, te cilet caktohen nga vete themeluesi.--

Neni 13

Themeluesi ka te drejte te vendose edhe per zvogelimin e kapitalit themeltar. Ne rast humbje themeluesi perballon vete ne kufirin e vleres se kapitalit te tij.--

Neni 14

Themeluesi ka te drejte te beje transferimin e kapitalit themeltar ne pjese te caktuara dhe sipas kushteve te parashikuara ne ligjin per shoqerine turistike e tregtare.--

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noteriale.--

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie dhe ne rast ndarje pasurore ne mes bashkeshorteve. Githashtu ato jane lirisht te transferueshme tek bashkeshortet dhe femijet.--

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 15

Shoqeria turistike "TURIST ALBANIA DURRES" SHPK do te drejtohet nga vete themeluesi i saj Entela Anastasi. Ajo mund te caktojte persona per administrimin e saj, apo mund te caktojte edhe perfaqesues ligjore me ane te prokures.--

Neni 16

Për ushtrimin e aktivitetit të shoqerise themeluesi

FAQE 4

do të miratojë raportin e administrimit, llogaritë, inventarët, ndryshimin e statutit, ndryshimet e kapitelit e të tjera, me të drejtën që për këtë të kërkojë edhe ndihmesën e eksperteve e specialisteve të ndryshëm dhe këto të fundit me detyrimin që t'i nënshtrohen ruajtjes së sekretit profesional.-

Neni 17

Shoqëria do të drejtohet nga themeluesi i saj Entela Anastasi, ndërsa administratori i saj mund të caktohet në çdo kohë prej tij.-

Ato do të përfaqësojnë shoqërinë në të gjithë marrëdhëniet e saj juridik e administrative, do të nënshtrojnë gjithë dokumentacionin e shoqërisë, do të marrin vendime për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, për organizimin e punës e të tjera.-

Neni 18

Administratori do të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.-

Në marrëdhënie me të tretët administratori angazhin shoqërinë nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.-

Neni 19

Administratori për gatit raportin për të gjithë marrëveshjet e arritura dhe veprimet e kryera për llogari të shoqërisë dhe ia paraqet presidentit të shoqërisë e jep llogari para tij.-

Neni 20

Administratorit nuk i lejohet të kontraktojë me çfarëdo lloji forme, nuk i lejohet të marrë hua tek shoqëria, të japë palqimin në emër të saj për paradhënie, si dhe të bëhet dorezues apo të garantojë në emër të shoqërisë angazhimet ndaj të tretëve.

Ai përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, të statutit apo për shkelje të veprimeve e vendimeve që marr drejtuesi i shoqërisë apo përfaqëuesi

ligjor i saj.P. keshtu ai pergjigjet edhe per fajetë tij te kryera gjate administrimit te shoqerise.-

Neni 21

Per veprimet e administratorit,per disa veprime apo nje veprim administrativ,presidenti i shoqerise ka te drejten te kerkoje eksperte te ndryshem.--

BIENACI DHE TE ARDHURAT

Neni 22

Veprimet ekonomike te finances se shoqerise do te mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.-

Per zhvillimin e aktivitetit financiar te shoqerise do te caktohen edhe eksperte kontabel nga drejtuesi.-

Per cdo periudhe ushtrimore, administratori apo eksperti kontabel do te nxjerrin bilancin me rezultat fitim humbje.-

Te ardhurat neto, pas vecimit te fondeve ligjore dhe shlyerjes se detyrimeve ligjore etje., i mbesin shoqerise.-

SHPERNDARJA DHE SHNDRIMI I SHOQERISE

Neni 23

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "TURIST ALBANIA-DURRES mund te shndrrohet ne nje lloj shoqerie tjeter me miratim te drejtuesit te saj.- -

Ajo mund te shperndahet ne cdo kohe per shkaqe te ndryshme si humbja e kapitalit, pamundesi e zhvillimit te veprimtarise e shkaqe tjera.- -

Ne rastet e sipërme shoqeria vendos per menyrën e likuidimit te duke treguar kujdes qe te likujdoje ne radhe te pare detyrimet ligjore dhe ndaj personave te trete.-

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 24

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet plotesimeve me vendim te drejtuesit se kesaj shoqerie, ligjit per shoqerite turistike e tregtare dhe dispozitave tjera ligjore qe jane ne fuqi.- -

Neni 25

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'i shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje si pjese perberese e dokumentacionit te shoqerise turistike me pergjegjesi te kufizuar "TURIST ALBANIA-DURRES "

Neni 26

FAQE 6

Zgjidhja e konflikteve do te behet nga drejtuesi i kesaj shoqerie dhe ne pamundesi ne rruge gjyqesore sipas parashikimit ne ligj.--

DREJTUESI I SHOQERISE
(ENTELA ANASTASI)



REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERKVE

Nr. 941 Rep., Nr. K. l. 544

: V E R T E T I M

Sot, me njezet e gjasht shtator, nentehdjete e kater, dite e Hënë para meje Ali Turku, noter ne Durres, u paraqit perpiluesja e ketij statuti Entela Zisi Anastasi e dl. 1972, banuese ne lagje 17, rruga Dëshmoret, 990 D, rres, e cila eshte madhore dhe ka notesi per te vepruar qe, pasi e lexoi kete statut dhe e gjeti te rregullt, e nenshkroi me deshire te plote dhe vullnet te lire ne prezencen time. Une noteri, pasi verifikova identitetin e saj, vertetoj.--

NOTERI
(ALI TURKU)

